



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar 06. 01. 2021			
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
29	522	529	



Republika e Kosovës
Komuna Drenas
Drejtoria për Bujqësi Pyltari dhe Zhvillim Rural
AUTORITETI PYJOR KOMUNAL

LËNDA: Njoftim .

Në bazë të ligjit për Pyjet e Kosovës 2003/3 Plotësim ndryshimin e këtij Ligji, Neni 12, UA Nr.07/2010, UA. Neni 2, Pika 2, ju njoftojmë se afati për pranimin e kërkesave për prerje në Pyje Private është deri me datën 31.03.2020, pas kësaj date nuk pranohen kërkesat, vetëm në raste të jashtëzakonshme (arsyetim të veçantë) mund të bëhet edhe pas kësaj date.

Kriterët dhe dokumentet që duhen të plotësohen për aplikim dhe marrje të Lejes për damkim-prerje në Pyje Private në rast se ngastra në fjalë lejon shfrytëzimin janë:

- Kërkesa për aplikim,
- Kopje e dokumentit të identifikimit (Letër njoftim),
- Lista poseduese (duhet të jetë më e re se 6 muaj),
- Kopja e planit me koordinata në çdo thyerje të ngastres (së paku 4 pika), koordinatat duhet të jenë origjinal nga zyra Kadastrale e jo të shkruara me dorë.

Në rast se personi që bënë kërkesën për prerje nuk është pronari i Ngastres atëhere duhen këto dokumente shtesë:

- Certifikatë e lindjes së parashtruesit të kërkesës dhe pronarit,
- Autorizim nga noteri për shfrytëzim të parceles (parashtruesi i kërkesës),
- Në rast se parcela në fjalë është e ndarë në disa (Pjesa e pronës psh. 1/2 ose 1/3 etj.) atëhere duhet një pelqim për shfrytëzim nga të gjithë bashkëpronarët .

Vërejtje:

Nga Drejtorinë Komunale – Sektori i Autoritetit Pyjor Komunal-Drenas nuk do të bëjnë pranimin e Lëndeve-kërkesave për damkim në Pyje Private po i plotësuar të gjithë kriterët e nevojshme (të cekura me lartë).

Datë.04.01.2021

Drejtoria i DBPZHR-së
Anita Avdullahu-Dvorani

